



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar , në Nenin 67 dhe 68 të Ligjit për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës Nr.06/L-114, Ligjin për Institucionet e Kulturës, Ligjin Nr. 04/L-164, për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota" dhe për Ansamblet Tjera, Statutin e AKKV "Shota, Rregulloren (QRK)Nr.15/2018, për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Përformuesve të Kulturës dhe të Punonjësve Professional të Trashëgimisë Kulturore dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpalle :

## KONKURS

**Titulli i punës:** Valltare dy (2) pozita

**Institucioni:** AKKV "Shota"

**Kategoria funksionale /Page fikse:** 521 €

**Numri i referencës:** RN00009459

**Kodi:** RPC0003198

**I përgjigjet:** Udhëheqësit Artistik të AKKV-Shota

**Vendi:** Prishtinë

**Detyrat dhe përgjegjësitë:** Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit Artistik te AKKV-Shota, kryen detyrat dhe përgjegjesite e meposhtme:

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Merr pjesë në provat e rregullta ditore në kohëzgjatje prej katër (4) orëve;
2. Paraprakisht përgatit për vallet në repertuar;
3. Kryen detyra profesionale sipas pozicionimit-valltarit;
4. Përgatitet në prova për tu prezantuar në koncerte;
5. Interpreton pjesë sipas pozitës në koreografi;
6. Interpreton në formacione-grupe;

7. Interpreton (luajtjen)e lëvizjeve vallëzuese që i mëson nga koreopetitori, koreografi;
8. Kryen punë të tjera profesionale sipas kërkesës së mbikëqyrësit;

#### **Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë**

1. Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë:

1.1 të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;

1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;

1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;

1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;

1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

#### **Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:**

1. Duhet të ketë të kryer Shkollën e Mesme;

2. Estetika (ana vizuele) lartësia trupore për femra mbi 1.67 m;

3. Përparësi kanë të gjithë ata konkurrues, që kanë qenë anëtar të ansambleve të këngëve dhe valleve;

4. Aftësi për të punuar në grupe;

5. Vërtetimi që nuk është nën hetime.

**Procedurat e konkurrimit:** Përzgjedhja e valltareve në AKKV "Shota", bëhet përmes audicionit.

**Akte ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:** Ligji për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës Nr.06/L-114, Ligjin për Institucionet e Kulturës, Ligjin Nr. 04/L-164, për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota" dhe për Ansamblet Tjera, Statutin e AKKV "Shota, Rregulloren (QRK) Nr.15/2018, për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës dhe të Punonjësve Professional të Trashëgimisë Kulturore dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik .

Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

**Kohëzgjatja e emërimit:** Emërimi është pa afat të caktuar.

#### **INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDITATËT**

Data e njoftimit në webfaqen unike të procedurave të konkurimit <https://konkursi.rks-gov.net> është prej dt. 15.07.2022 deri me dt.13.08.2022, ndërsa data e aplikimit është nga data 14.08.2022 deri me datën 28.08.2022.

Përveç web faqes unike të procedurave të konkurimit, konkursi publikohet edhe në Web faqen e MKRS-se.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit , ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil e administratës publike qendrore dhe lokale.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.**Paraqitja e kërkesave:** Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Terezë" Nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211921 ( apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>).